



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 12 tetor 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Naim Fetahu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Fikrim Damka, Bali Muharremaj, Synavere Rysha dhe Enver Hoti.

Mungoi: Enver Hoti

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Besnik Osmani, Qendresa Mulaj, Bujar Bajraktari, Valon Bytyçi, Vlora Mehmeti - ZKA. Abdullah Hoti, Fatmir Plakiqi, Kosum Aliu - Ministria e Financave. Mahir Yagcilar, Arton Berisha - MAP. Kenan Gashi, Naxhie Sadiku- rrjeti i OJQ-ve. Imet Rrahmani, Musa Rexhaj, Afërdita Hoxha, Bekim Fusha -MSH. Curr Gjoci, Muzafer Kalanderi, Sadik Zejnullahu, –SHSKUK.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 21.09.2016.
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2015.
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015.
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF e Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015.
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015.
7. Të Ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.09.2016

***Kryetari,** konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.09.16, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2015

Faton Topalli, kryetar, për të diskutuar Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2015, kemi ftuar përveç Auditorit të Përgjithshëm, Ministrin e Financave dhe Ministrin e Administratës Publike. Me këtë hapi diskutimin.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm, në pika të shkurtra prezantoi Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2015. Në Raportin Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës (RVF/BK) për vitin 2015, ne kemi dhënë Opinion të Kualifikuar me Theksim të çështjes për shkak të mos konsolidimit të pasqyrave individuale financiare dhe mos shpalosje adekuate të informatave sa i përket shënimeve shpjeguese. Përkundër kësaj, ka disa zhvillime pozitive në raportimin financiar për vitin 2015, duke përfshirë rritjen e realizimit të të hyrave nga tatimet, financimi nga huamarrjet e brendshme si dhe performanca e mirë buxhetore në realizimin e pagesave. Megjithatë, ka hapësirë për përmirësimin e mëtutjeshëm në Raportimin Financiar nga Organizatat Buxhetore individuale, dhe në një numër të caktuar të fushave. Kjo kryesisht ka të bëjë me klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve si investime kapitale. Po ashtu cilësia e informatave lidhur me shpalosjet duhet të rritet për të qartësuar llogaritë e arkëtueshme në nivel shtetërorë, si dhe të forcohet procesi i identifikimit dhe i regjistrimit të pasurive kapitale në SIMFK. Është bërë progres në fushën e menaxhimit të pagesave nga palët e treta, po ashtu në shlyerjen e obligimeve të papaguara. Opinioni i auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 është Opinion i Kualifikuar me Theksim të çështjes. Baza për kualifikim të opinionit ishte keq klasifikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere në vlerë prej 25,307,551€ si investime kapitale. Nga kjo shumë, 23,171,222€ ishin keq klasifikuar për shkak të buxhetimit jo të drejtë të shpenzimeve nga Ministria e Financave, kurse 2,136,329€ janë keq klasifikuar nga vet Organizatat Buxhetore si pasojë e gabimeve dhe aplikimit jo të drejtë të planit kontabël.

Mahir Yagcilar, Ministër MAP, theksoi se ne jemi pajtuar me të gjeturat e raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2015, megjithatë dëshirojë të theksoi MAP si e vetme e ka të pamundur implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP dhe ZKA. Sidoqoftë ne së bashku do të hartojmë një plan veprimi për ti adresuar çështjet e ngritura nga AP dhe KMFP.

Abdullah Hoti, Ministër MF, paraqiti në pika të shkurtra përpjekjet e Ministrisë së Financave për të adresuar të gjitha çështjet e ngritura nga AP dhe KMFP, si dhe hapat që MF ka ndërmarrë në ngritjen e kapaciteteve të brendshme të institucioneve si në planifikim po ashtu edhe në realizim të buxhetit. Përveç kësaj ne kemi bërë progres në rritje të buxhetit, prokurimi elektronik, prokurimi i centralizuar etj. Deficiti buxhetor ishte zvogëluar me 1.5% nga 3% sa ishte planifikuar. Rishikimi i Ligjit për kontrollin e brendshëm financiar dhe aprovimi i tij nga Qeveria janë disa nga të arriturat e MF dhe Qeverisë në përgjithësi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgatitja e Programit Kombëtar për certifikim të Auditorëve të Brendshëm etj. Ne kemi propozua një këshillë të përbashkët në mes MF Auditorit të Përgjithshëm dhe përfaqësuese të tjerë. Çështje kjo që është paraparë me Ligjin mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit.

Faton Topalli, theksoi, se Qeveria në këtë rast është në anën e mbështetjes nga dy anët në njërin anë nga AP dhe në anën tjetër nga KMFP, të vetmit ata që po mundohen të jenë në anën tjetër të kësaj jemi ne pjesëtarët e opozitës. Opinioni i auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 është Opinion i Kualifikuar me Theksim të çështjes. Baza për kualifikim të opinionit ishte keq klasifikimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere në vlerë prej 25,307,551€ si investime kapitale. Nga kjo shumë, 23,171,222€ ishin keq klasifikuar për shkak të buxhetimit jo të drejtë të shpenzimeve nga Ministria e Financave, kurse 2,136,329€ janë keq klasifikuar nga vet Organizatat Buxhetore si pasojë e gabimeve dhe aplikimit jo të drejtë të planit kontabël. Në përgjithësi kontrolli i brendshëm financiar nuk ka ndonjë progres krahasuar ndër vite, pa dallim nga çdo organizatë buxhetore. Mos implementimi i rekomandimeve është mjaft shqetësues. Numri i rekomandimeve nga viti 2014 dhe 2015 është pothuajse i njëjtë, po edhe niveli i zbatimit të rekomandimeve është jo më i lartë se 30%. Po ashtu pyeti për shumën e mjeteve prej 185 milion euro si të hyra të arkëtueshme nga ATK dhe Dogana të cilat nuk ishin shpalosur në PVF-të e viteve paraprake ndërsa këto ishin paraqitur në PVF-të e vitit 2015. Cila është arsyeja e mos deklarimit të këtyre të hyrave? Borxhet e pa paguara në shumën prej 145 milion euro, pjesa me e madhe tek MMPH si dhe tek MI, ishin disa nga rekomandimet e pa implementuara edhe nga raportet e viteve të kaluara.

Bali Muharremaj, pyeti lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga ana e Organizatave Buxhetore, si dhe çfarë progresi është bërë me menaxhimi e listës së pagave si dhe fillimin e zbatimit të sistemit elektronik tek burimet njerëzore?

Ali Sadriu, theksoi se edhe këtë vit problem në vete është regjistrimi i pasurisë, përkundër rekomandimeve të dhëna nga KMFP, ende kemi dy sisteme të cilat po gjenerojnë të dhëna të kundërta, Pyeti çka është ndërmarrë në këtë drejtim?

Abdyl Ymeri, theksoi se raporti është gjithëpërfshirës dhe i konceptuar mirë. Megjithatë përkundër përmirësimeve që shihen në raport në fushën e financave publike, ende kemi ngecje përderisa opinioni është i kualifikuar me theksim të çështjes. Keq klasifikim i buxhetit dhe shpenzimet në kode ekonomike të gabuara.

Faton Topalli, theksoi shtoi se Administrata ka përgatitur disa rekomandime të grupuar në dy grupe si të përgjithshme dhe rekomandime individuale. Rekomandimet e grupuara janë të adresuara për Qeverinë ndërsa këto individuale për OB e veçanta. Propozojë që raporti të shkon për seancë me këto 5 rekomandime të përgjithshme, të cilat janë:

1.Qeveria e Republikës së Kosovës të përgadisë raport kthyes në lidhje me rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm (AP), Komisioni për Mbikqyrje të Financave Publike dhe Seanca Plenare për Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2014. Duke detajuar progresin e arritur dhe duke identifikuar barrierat që kanë penguar implementimin e plotë të rekomandimeve. 2.Qeveria e Republikës së Kosovës të përgadisë një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm nga Raporti Vjetor i Auditimit 2015, si dhe të raportojë për progresin e arritur në zbatimin të këtij plani, në baza tremujore, në Komisionin për Mbikqyrje të Financave Publike. 3.Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga të gjitha Organizatat Buxhetore që të implementojnë dhe raportojnë mbi procesin sistematik të implementimit të rekomandimeve të auditimit, me raporte tremujore të progresit të dërguara në Ministri të Financave dhe në KMFP. 4.Kuvendi i Republikës së Kosovës të ushtrojë ndikim tek Qeveria për të siguruar që rekomandimet e KMFP-së dhe AP për vitin aktual dhe ato paraprake po adresohen plotësisht duke vendosur kontrolle efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar vlerën për para. Kuvendi i Republikës së Kosovës të kërkojë nga Qeveria të ketë një strategji e cila demonstroi një qasje të koordinuar për maksimizimin e performancës së komunave.

Përfundim

KMFP, vendosi që Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2015, të adresohet për seancë plenare së bashku me 5 rekomandimet e KMFP-së të dhëna më lartë.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, tha se në mungesë të Ministrit të Komuniteteve kjo pikë nuk do të shqyrtohet sot, për datën e mbajtjes së takimit të radhës do të vendosë komisioni.

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF e Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, theksoi se në këtë pikë do të shqyrtohet PVF e audituara për MSh për vitin 2015, me këtë hapi diskutimin.

Bujar Bajraktari, udhëheqës i ekipit të auditimit ZKA, Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se në kuadër të MSH-së ekzistojnë kontrolle të brendshme në shumicën e fushave të veprimtarisë. Megjithatë, ekzistojnë dobësi të mëdha në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin, kompensimin e pagave, dhe subvencionet. Gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe informatat jo të sakta rreth pasurive dhe stoqeve janë reflektuar në PVF dhe kanë ndikuar në theksimin e çështjes. Procesi i vetëvlerësimit dhe përgjigjja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës. Për PVF-të e MSH-së për vitin 2015 kemi dhënë Opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes. Baza për theksim të çështjes ishte se informatat e shpalosura në PVF në lidhje me pasuritë fikse dhe stoqet e barnave janë materialisht të nënvlerësuar. Pasuritë kapitale janë nënvlerësuar për rreth 2,279,794€, dhe stoqet e barnave janë

nënvlerësuar për rreth 1,320,592€. Përveç kësaj kishte keq klasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike në vlerë totale prej 297,171€. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të keq buxhetimit të shpenzimeve, dhe pjesërisht për shkak të gabimeve gjatë procesimit të pagesave. Shpenzimet prej 117,397€ kanë qenë të buxhetuara në kategori të gabuara ekonomike (këto janë të detajuara në raport). Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MSH-së ka rezultuar në 24 rekomandime kryesore (4 nga rekomandimet ishin për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar - SHSKUK e cila nga viti 2015 funksionon si organizatë buxhetore e pavarur nga Ministria). Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 2 rekomandime ishin implementuar plotësisht, 6 janë ishin në proces të implementimit derisa 12 të tjera nuk ishin implementuar akoma. Si rrjedhojë e mos implementimit të duhur të rekomandimeve, disa nga to janë përsëritur edhe këtë vit. Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes dhe raportimit brenda MSH-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien e institucioneve që janë në vartësi të Ministrisë, menaxhimit e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Derisa mangësitë e paraqitura gjatë procesit të konsolidimit të PVF-ve kanë rezultuar në shpalosjen jo të saktë të informatave rreth pasurive, stoqeve, obligimeve dhe të arkëtueshmeve. Njësia e Auditimit të Brendshëm, nuk kishte arritur ta realizoj planin e punës pasi që janë kryer vetëm nëntë nga pesëmbëdhjetë auditimet e planifikuara. Niveli i Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë implementuar vetëm në një numër të vogël të rasteve nga ana e menaxhmentit. Komiteti i Auditimit kishte mbajtur pesë takime gjatë 2015 megjithëse na janë ofruar procesverbalet e vetëm tri takimeve. Për këtë arsye në nuk ishim në gjendje për të vlerësuar kontributin e tyre.

Fikrim Damka, theksoi se në PVF-të e Audituar për MSH për vitin 2015, kemi vërejtur se shpenzimet për blerjen e barnave prej 6 milion euro është dashur të auditohen më në detale. Mos zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga AP dhe KMFP. Shpenzimet nga prokurimi prej 12 milion euro me vetëm një numër të vogël të rregullsive të konstatuara.

Bali Muharremaj, shtoi se problemet në Shëndetësi prej vitit në vit janë të njëjta, pa ndonjë progres të arritur.

Hajdar Beqa, theksoi se për vitin e kaluar ishin 24 rekomandime, 12 prej tyre nuk janë implemetuar ende, ku janë defektet në këtë? Të gjeturat përsëriten nga viti në vit, nuk është duke u bërë progres në këtë drejtim?

Synavere Rysha, shtoi se çështja e auditimit dhe mos implementimi i rekomandimeve merr kohë, numri i madh i rekomandimeve prej 24 sosh dhe vetëm gjysma e tyre janë adresuar, mendojë se në raportet e radhës do të shihet progres.

Imet Rrahmani, Ministër MSH, Ministria e Shëndetësisë mirëpret bashkëpunimin me Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të financave Publike dhe fton për një bashkëpunim edhe më të ngushtë. Gjithashtu vlerësohet edhe raporti i Auditorit të Përgjithshëm, duke specifikuar se, Rekomandimet e Auditorit mund të jenë në numër më pak sikur disa komente nga Ministria e Shëndetësisë të ishin marr për bazë, dhe sikur problemet e ngritura të jenë vetëm të fushës së shëndetësisë dhe zgjidhja e tyre të varet vetëm nga MSH.

MSH, që me rastin e pranimit të Raportit dhe rekomandimeve ka hartuar Planin e Veprimit për implementimin e rekomandimeve, deri te formimi edhe i Grupit implementues. Gjithashtu është

ngritur edhe niveli i aktiviteteve nga Njësia e Auditimit të Brendshëm si në cilësi ashtu edhe në sasi. Nga 14 aktivitete të parapara për auditim të rregullt janë realizuar deri tash 13, dhe gjithmonë kjo NjAB është e gatshme të auditoj çdo problematikë të ngritur nga Ministri, Kabineti, apo zyrtarët civil, në MSH dhe njësitë vartëse. Vlen të ceket edhe puna shumë e mirë e komitetit të Auditimit të Brendshëm. U cekën se kemi disa pozita me Ushtrues detyre. Ju informoj se MSH ka marr masat për evitimin e kësaj “dukurie”. Ne deri tash kemi zgjedhur me konkurs Drejtorin në departamentin për Zhvillim Strategjik dhe drejtorin për shërbime shëndetësore. Duhet të e kemi parasysh se procedurat Ligjore janë mjaft të komplikuar dhe se kërkojnë respektim striktë; së pari konkurset e brendshme, pastaj të jashtme e deri te Këshilli i pavarur Mbikëqyrës i cili shqyrton ankesat dhe shpesh anulon konkurset. Kësaj procedure i paraprin gjithmonë marrja e lejes për shpallje të vendeve të lira nga Thesari (MF) dhe MAP.

Ju rikujtoj vendet e lira në AFSH, problem ky i trashëguar. Edhe pse kemi vende, kemi buxhet ene jemi në pritje të lejimit të pozitive, sikurse edhe për Drejtor të zyrës së Auditimit dhe departamentit të Administratës dhe atij Ligjor. Moslejimi i pozitive në AFSH sfidon shumë implementimin e Ligjit të Sigurimeve shëndetësore. U tha që disa pozita menaxheriale në IKSHPK janë me orar të shkurtuar. Ata të gjithë janë profesor ose asistent që pagën bazë e kanë në UP dhe sekondaren në IKSHPK. Ju them se : MSH, MASHT, UP dhe Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë kanë ngritur nivelin teknik të një Komisioni me vendim të Qeverisë, edhe në nivele politike, dhe po punohet në unifikimin e pagave per profeosret deh asisstentet, ashtu që të kemi edhe zgjidhjen e këtij rekomandimi edhe lirim të vendeve të reja të punës, për mjek dhe punëtor tjerë. Gjithashtu ne kemi marr të gjitha masat që Odave të sigurohet identifikimi i taksave nga kompetencat që ushtrojnë, përmes Unirefave të veçantë, që mundëson shfrytëzimin e buxhetit nga Odat dhe pavarësimin financiar të plot të tyre nga 1 Janari 2017. “Blerja e mobileve dhe IT aparaturës”?, Në angazhimet e Ministrisë për krijimin e kushteve të mira për veprimtari të Odave janë bërë këto shpenzime. Odave ju kemi siguruar hapësira në hapësirat ku ka funksionuar më herët Këshilli Gjygjësor i Kosovës. Sfiduese janë edhe subvencionet. Ne kemi trashëguar rreth 260 specializant që janë paguar nga subvencionet nga a e ashtuquajtura “performanca”. Ky numër është zvogëluar në 160 si rezultat i specializimit të tyre, por këtë vit ne jemi të detyruar që të respektojmë vendimet e Kuvendit dhe Ligjin e Rishikuar të Buxhetit për vitin 2016, dhe nga 1 Tetori do të paguhet edhe 355 specializant të tjerë përmes subvencioneve. Dihet se ata kanë nënshkruar një deklaratë ku marjnë përgjegjësinë individuale se nuk paguhet nga buxheti i Kosovës ose ndonjë institucion privat. Ne sipas rekomandimeve të Auditorit 17 prej tyre ju a kemi ndërpre financimin. Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore ka kërkuar trajtim të disahershëm dhe ne jemi tash para finalizimit të Udhëzimit të ri administrativ. Vitin e kaluar i kemi shpenzuar në këtë sferë 7.8 milion. Barazimi me spitalet ka mundësuar që të ‘zëvendësohet’ pa dashje detyrimi i qytetarëve me fatura për shërbimet e marra. Ne shpesh mjetet e tepërta nëpër Spitale i kemi orientuar për pacientë të tjerë. Përsëritja e rekomandimeve nga viti në vit behet thjeshtë se shumica nga rekomandimet nuk janë thjeshtë kompetencë vetëm e MSH-së.

Faton Topalli, pasi nuk pati të interesuar për këtë pikë u vendos që:

Përfundim

KMFP, vendosi që Raporti i Auditimit për Ministrinë e Shëndetësisë, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, të mos adresohet për seancë plenare.

6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015.

Faton Topalli, theksoi se KMFP ka filluar të implementojë projektin e raportueseve dhe për këtë fjalën ja dha deputetit, Fikrim Damka në cilësinë e raportuesit.

Bujar Bajraktari, theksoi se Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se në kuadër të SHSKUK-së ekzistojnë kontrolle të brendshme në shumicën e fushave të veprimtarisë. Megjithatë këto kontrolle nuk kanë funksionuar mirë, dhe kanë rezultuar me prezantim jo të duhur të informatave në PVF, si dhe të gjetura të shumta në pothuajse të gjitha fushat e menaxhimit financiar. Si të tilla kontrollet menaxheriale duhet të përforcohen dhe implementimi i tyre duhet të monitorohet në vazhdimësi. Për PVF-të e SHSKUK-së për vitin 2015 ne kemi dhënë Opinion të Pamodifikuar me theksim të çështjes. Baza për Theksim të çështjes ka të bëjë me shpalosjen e informatave rreth pasurive fikse dhe stokeve të barnave të cilat nuk kanë qenë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Kjo për faktin se vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PVF-të e vitit 2015 është mbivlerësuar për rreth 860,091€, dhe saldo përfundimtare e stokeve të barnave është nënvlerësuar për rreth 1,606,025€. Këto çështje janë ngritur për shkak se regjistrat e pasurive dhe informatat rreth stokeve nuk janë menaxhuar në mënyrën e duhur (për më tepër detaje referohuni raportit). SHSKUK është pavarësuar si Organizatë buxhetore në fillim të vitit 2015. Prandaj auditimi për vitin 2014 ka qenë i përbashkët me Ministrinë e shëndetësisë. Nga rekomandimet e dhëna për PVF-të e 2014, 11 kishin të bëjnë me SHSKUK-në dhe strukturat në kuadër të saj. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 2 rekomandime ishin implementuar plotësisht; 2 janë implementuar pjesërisht, ndërsa 7 të tjera nuk ishin implementuar akoma. Me konkretisht ekziston incizimi.

Fikrim Damka, paraqiti në pika të shkurtra disa nga vërejtjet e raportit të auditimit, planifikim i dobët i buxhetit, menaxhimi jo efektiv i kontratave, disa projekte në QKUK-ë dhe në Spitalin e Ferizajt, të cilat kanë bërë tejkalimin e buxhetit për 30% nga vlera e kontratës.

Hajdar Beqa, shtoi se raporti është më shumë të gjetura dhe shumë i qartë. Po ashtu pyeti pse QKU nuk ka patur një plan të prokurimit të përgatitur në fillim të vitit? Pranimi i mallit pa komision të pranimit etj?

Synavere Rysha, Pyeti se në disa klinika ka pozita të drejtorit me ushtrues të detyrës me gjatë se 3 muaj?

Bali Muharremaj, Pyeti me problemin e aparaturave në Spitalet Regjionale që në shumicën e rasteve janë jashtë funksionit, po ashtu barnat e listës esenciale të sigurohen paraprakisht. Të paktën higjiena të jenë në nivel të kënaqshëm.

Curr Gjoci, paraqiti një rezymë të shkurtër për punën e bërë në kontest të adresimit të rekomandimeve, raporti është publik dhe dihet botërisht të gjeturat. Ne jemi pamvarsu nga MSH megjithatë po kemi probleme për operim pa mbështetje financiare. Është e vërtetë se ka disa raste të shkelje të procedurave për shkak të mungesës së stafit.

Fikrim Damka, theksoi se ka dallim të operimit nga një repart në tjetrin megjithatë ne jemi dëshmitar se shërbimet janë përmirësuar dukshëm nga integrimi i Spitaleve Regjionale në SHSKUK. Po ashtu pyeti për stokun barnave me një dallim prej 1.6 milion euro?

Curr Gjoci, Asnjë Barnatore nuk ka qenë e licencuar nga SHSKUK, ndërsa sa i përket stoqeve për barnat, në kemi evidencë por nuk janë paraqitur në PVF-të, e veçanërisht pjesa e barnave që ka qenë donacion.

Përfundim

KMFP, vendosi që Raporti i Auditimit për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, të mos adresohet për seancë plenare.

Takimi përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli